

PROBLEME DHE DISKUTIME

MENELLA TOTONI

SI DUHET KUPTUAR NJËSIA THEMELORE SINTAKSORE?

Çështja e kuptimit të fjalisë dhe e natyrës gramatikore të saj, që është nga më të rëndësishmet dhe njëkohësisht nga më të ndërlikuarat e çdo sintakse, ende nuk ka gjetur një zgjidhje të kënaqshme në shkencën tonë sintaksore, ku mund të thuhet se janë përvijuar dy drejtime kryesore, që i kundërvihen njëri-tjetrit, të shfaqura, i pari, në sintaksat e shqipes qofshin këto shkollore, qofshin joshkollore (këtu janë lënë jashtë *konspekt-leksionet* e përgatitura nga M. Domi për studentët e Fakultetit, histori-filologji, meqë ato përfshijnë vetëm sintaksën e periudhës dhe ndonjë çështje nga sintaksa e fjalisë; këto do të përmenden për gjëra të veçanta në vendet përkatëse) dhe, i dyti, në studimet sintaksore, që janë bërë këto 15 vjetët e fundit për shqipen.

Në shumicën e sintaksave të shqipes fjalia është përkufizuar si mendim ose si gjykim i shprehur me fjalë¹. Në bazë të këtij përkufizimi qëndron identifikimi i gjuhës me mendimin, i fjalisë me gjykimin. Në sintaksat e tjera, të mëvonshmet, është bërë përpjekje për t'ju shmangur logjicizimit sidomos në përkufizimin e fjalisë, që ishte karakteristik për sintaksat e mëparshme. Në ato fjalia është përkufizuar si tog fjalësh, në disa edhe si fjalë, që shpreh një mendim të caktuar ose edhe një dëshirë, një ndiesi, një pvetje². Po pavarësisht nga ndryshimet në përkufizimin e fjalisë, që duket sikur i ndajnë sintaksat e shqipes në dy grupe, ato në thelb nuk ndryshojnë nga njëra-tjetra, sepse në të gjitha fjalia kuptohet si njësi strukturoro-logjike. Kjo do të thotë që struktura e fjalisë është parë nën prizmin e logjikës, që ajo është identifikuar me strukturën e gjykimit³. Kjo duket qartë në trajtimin e këtyre çështjeve: 1) në njohjen dhe në përshkrimin e tipeve strukturore të fjalisë; 2) në trajti-

1) A. Xhuvani, *Njohuritë e para të syntaksës shqipe*. Pjes' e parë. 1922, f. 5; I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe, sidomos e toskërishtes*, V. 1927., f. 147; J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Sh. 1942, f. 5; K. Cipo, *Gramatika e gjuhës shqipe*, T. 1949; S. Kolgeci, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1955, f. 53.

2) M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa*, T. 1957, f. 3; M. Domi — N. Havjari, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa*, T. 1963, f. 3; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa II, Sintaksa*, Për shkollat pedagogjike, T. 1964, f. 3; N. Havjari, *Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa*, T. 1963, f. 5; S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe* (dispensë), Pjesa I, T. 1959, f. 39.

3) Shih për këtë edhe S. Floqi, *Rreth disa çështjeve të fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe*, BShSh, 1955, 3, f. 51.

min e gjymtyrës kryesore të fjalive me një gjymtyrë kryesore dhe 3) në kuptimin e kallzuesisë.

1. — Në të gjitha sintaksat fjalia me kryefjalë e kallzues, që nga ndërtimi strukturor është e ngjashme me strukturën e gjykimit (S-P), është marrë për model, është mbajtur si tipi i plotë, ideal i fjalisë⁴. Të gjitha tipet e tjera janë parë në kuadrin e këtij tipi dhe nën këtë prizëm e pikërisht për këtë arësyje shmangjet nga ky tip i plotë janë shpjeguar si «mungesë», «lënë jashtë (elipsë)» dhe për të është zbatuar pa kriter parimi i nënkuptimit të elementeve që «mungojnë» dhe që «janë lënë jashtë»⁵. Gjatë analizës sintaksore në këto fjali, bile edhe në çdo replikë të ligjërit dialogjik, vendosen elementet (gjymtyrët) e fjalisë «të lëna jashtë», sepse nënkuptohen.⁶

2. Identifikimi i strukturës së fjalisë me strukturën e gjykimit, siç e ka vënë në dukje S. Floqi,⁷ duket qartë dhe në trajtimin e gjymtyrës kryesore të fjalive të ashtuquajtura mungesore, e cila në këto sintaksa është identifikuar me kryefjalën ose me kallzuesin e fjalive të «plota». Kështu, p.sh., në fjalitë *Bubullin, Tërmet*, fjalët *bubullin* e *tërmet* janë trajtuar përkatësisht si kallzues dhe kryefjalë. Kryefjala dhe kallzuesi i këtyre fjalive, që gjuhësisht nuk është shprehur, mendohet logjikisht vetëm në sajë të këtij paralelizmi gjykim-fjali. Në fakt, gjymtyrët *bubullin* dhe *tërmet* nuk mund të identifikohen as me kallzuesin, as me kryefjalën e fjalive «të plota», sepse nuk hyjnë në lidhje predikative me fjalë të tjera. Në fjali të tilla nuk gjen shprehje fjalësore ai gjymtyrëzim që pa dyshim përfshihet në vetë komunikimin, kështu që *bubullin* e *tërmet* janë të vetmet gjymtyrë kryesore, nëpërmjet të cilave shprehet një gjykim.

3. Si tipar strukturor i fjalisë në sintaksat e shqipes është dalluar folja si në formën e saj të shtjelluar (vetore) dhe në formën e pashtjelluar. Ajo shihet si i vetmi element organizues i fjalisë, pa të cilin s'ka fjali. Në disa sintaksa njihen fjali njëfjalëshe pa folje, po këto trajtohen si fjali mungesore dhe në analizën sintaksore u shtohet folja-kallzues që u «mungon»⁸. Kështu, në këto sintaksa është vënë shenja e barazisë midis foljes dhe kallzuesit. Folja, si tipar themelor i fjalisë është kuptuar si kategori që shpreh veprim, dhe, në këtë mënyrë, nuk është bërë asnjë dallim ndërmjet ndërtimeve që kanë si bërthamë konstruktive një formë foljore të shtjelluar (vetore), dhe ndërtimeve që kanë si bërthamë konstruktive një formë foljore të pashtjelluar. Në bazë të kategorisë së kallzuesisë është vënë kuptimi kategorial leksikor i foljes dhe nuk janë vënë

4) A. Xhuvani, *Vep. e cit.*, f. 5; I.D. Sheperi, *Vep. e cit.*, f. 145; S. Prifti, *Vep. e cit.*, Pj. I, f. 41.

5) A. Xhuvani, *Vep. e cit.*, f. 28; I.D. Sheperi, *Vep. e cit.*, f. 148; J. Rrota, *Vep. e cit.*, f. 8; M. Domi, *Vep. e cit.*, f. 5; S. Kolgeci, *Vep. e cit.*, f. 12; S. Prifti, *Vep. e cit.*, Pj. I, f. 43. Në sintaksën e M. Domit për shkollat pedagogjike është kufizuar përdorimi i parimit të nënkuptimit të elementeve që «mungojnë», megjithatë fjalitë me folje pavetore dhe me folje në vetën I e II nuk janë dalluar si tipe fjalish, po janë trajtuar në kuadrin e fjalive me dy gjymtyrë kryesore, kështu, vërejtja e S. Floqit për sintaksat shkollore të botuara para 1955 *Rreth disa çështjeve...* BShSh 1955, 3, f. 51) se larmia e madhe e fakteve gjuhësore të shqipes është kufizuar në disa skema të varfëruara, mbetet e drejtë edhe për këtë sintaksë.

6) Shih për këtë: A. Xhuvani, *Vep. e cit.*, f. 11; I.D. Sheperi, *Vep. e cit.*, f. 12; M. Domi, *Vep. e cit.*, I f. 7, II f. 3; S. Prifti, *Vep. e cit.*, Pj. I, f. 113.

7) S. Floqi, *Puna shkencore t'u përgjigjet më mirë kërkesave të shkollës*, gaz. «Mësuesi», dt. 13.11.1964 dhe *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF 1968, 1, f. 78.

8) Në konspekt-leksionet për studentët e Fakultetit hist. fil. M. Domi dallon si tip me vete fjalitë e pazbërthyeshme.

kategoritë morfologjike të saj: mënyra, koha dhe veta, dhe, në këtë mënyrë, është pranuar që fjalia shpreh një njoftim për realitetin, por jo domosdo edhe raportin e folësit me të.

Një kuptim i tillë i fjalisë është i lidhur me kuptimin tradicional të gjuhës në përgjithësi, sipas të cilit objekt i sintaksës është gjuha në formën e saj të shkruar, dhe ka pasur ndër të tjera këto pasoja: 1) është vënë shenja e barazisë midis fjalive të mëvetësishme dhe pjesëve të së ashtuquajturës periudhë; 2) është pranuar si njësi sintaksore krahas fjalisë edhe periudha.

Periudha⁹ është kuptuar si bashkim ose si grumbull fjalish që shprehin një mendim të plotë, është pranuar, pra, që përgjithësisht periudha ndryshon nga «fjalia» vetëm nga pikëpamja strukturore, sepse ka më shumë se një bërthamë kallzuesore. Mirëpo, në disa sintaksa mbahet si periudhë edhe një fjali e veçuar, që shpreh një mendim të plotë¹⁰. Në këto sintaksa nuk del e qartë, ç'kuptohet me «mendim të plotë», nuk thuhet asgjë se cilat tipe strukturore të fjalive të veçuara shprehin një mendim të plotë. Nocioni «mendim i plotë» mbetet i paqartë si nga pikëpamja e funksionit komunikativ, si nga pikëpamja e përmbajtjes logjike të fjalisë e të periudhës.

Duhet theksuar që periudha kuptohet si një tërësi vetëm logjiko-semanticke, po jo dhe si tërësi strukturore, ku struktura e çdo pjese të veçantë të periudhës është e lidhur dhe e kushtëzuar nga struktura e pjesëve të tjera. Ky konceptim ka përcaktuar edhe studimin mekanik të periudhës. Kështu, nga pjesët e periudhës është studjuar kryesisht e ashtuquajtura fjali e varur dhe kjo, siç e ka vënë në dukje edhe S. Floqi¹¹, është studjuar nga pikëpamja e kuptimit dhe e mjetit të lidhjes. Së ashtuquajturës fjali kryesore nuk i është kushtuar pothuajse fare vëmendja. Ç'është thënë për të, mund të përfshihet në disa vërejtje për kuptimin e për korrelacionin kohor të foljeve-kallzues në disa tipe periudhash ose për ndonjë korrelat.

*

Drejtimi i dytë nisët nga fakti që objekt i sintaksës është studimi i strukturës së gjuhës së gjallë, i ligjërimit, në tërësinë e faktorëve që e karakterizojnë atë, si gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë.

Sipas këtij drejtimi, fjalia kuptohet si «njësi tërësore e ligjërimit (dmth. njësi që nuk ndahet më tej në njësi të ligjërimit me po ato tipare strukturore) e formuar gramatikisht, e cila është mjet kryesor për formimin, shprehjen dhe komunikimin e mendimit». Si tipare themelore strukturore të saj janë dalluar intonacioni i komunikimit dhe kallzuesia¹².

9) J. Rrota në sintaksën e vet përdor termin *fjali e përbame* (grumbull fjalish), që i kundërvihet termit *fjali e veçume*. M. Domi në sintaksën për shkollat pedagogjike (T. 1964) dhe në *Sintaksa e gjuhës shqipe* (Materiale për studentët e Fakultetit historik-filologjik T. 1963 përdor më shumë termin *frazë*. Pranimi i këtyre termave nuk ka sjellë ndryshime as në konceptimin e njësisë, as në përshkrimin sintaksor.

10) I. D. Sheperi, *Vep. e cit.*, f. 146. K. Cipo, *Sintaksa*, T. 1952, f. 6; S. Kolgeci, *Vep. e cit.*, f. 67; S. Prifti, *Vep. e cit.*, Pj. II, disp. I, f. 3. M. Domi në sintaksën për shkollat pedagogjike, T. 1964 ka hequr dorë nga një trajtim i tillë.

11) S. Floqi, *Fjalia e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe*, BShSh 1956, 2, f. 6.

12) S. Floqi, *Rreth disa çështjeve të fjalisë së përbërë në gjuhën shqipe*, BShSh 1955, 3, f. 54; *Fjalia e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe*, BShSh 1956, 2, f. 4.

Intonacioni është kuptuar si mjet gramatikor, me anën e të cilit formohet fjalia. Në sajë të intonacionit të komunikimit fjala dhe togfjalëshi shndërrohen në fjali dhe hyjnë në gjuhë si njësi komunikative. Me anë të mjeteve të ndryshme intonacionore fjala fiton në fjali vlera të ndryshme komunikative dhe realizohet gjymtyrëzimi i fjalisë¹³.

Kallzuesia është kuptuar si kategori sintaksore, që tregon modalitetin e komunikimit, kohën dhe vetën, të cilat shprehen qartë me anë të formave foljore të shtjelluara (vetore), po që mund të shprehen edhe me mjete të tjera leksikore e gramatikore¹⁴. Kështu, në fjalitë nominative (*Natë., Makina!*) ose në fjalitë njëfjalëshe urdhërore esklamative (*Mos!, Zjarr!*) e modale (*Jo., Po., Natyrisht.*) mungesa e foljes nuk do të thotë edhe mungesë e kallzuesisë. Duke pasur intonacionin e plotë të një komunikimi, ato kanë njëkohësisht edhe karakterin kallzuesor të komunikimit¹⁵.

Ndërkaq, në studimet tona sintaksore¹⁶ mbetet ende i pasqaruar teorikisht raporti midis intonacionit dhe kallzuesisë si tipare themelore të fjalisë. Intonacioni, në fakt, nuk është pranuar si tipar karakteristik i qëndrueshëm i fjalisë. Si rrjedhim, edhe këtu janë trajtuar si fjali pjesët e së ashtuquajturës periudhë (fjali kryesore, fjali e varur), të cilat nuk formojnë një tërësi as intonacionore dhe as kuptimore, e, për këtë arsye, nuk mund të formojnë një njësi komunikative ashtu si një fjali e veçuar. Nga ana tjetër, është mbi vlerësuar kallzuesia si tipar i fjalisë, gjë që ka shpënë në pranimin e së ashtuquajturës periudhë si njësi sintaksore më e madhe se fjalia¹⁷. Kjo ka qenë arsyeja, besoj, që e ka detyruar S. Floqin të heqë dorë nga termi *fjali e përbërë*, që e ka përdorur në dy punimet e para të tij, dhe ta zëvendësojë me termin periudhë në punimet e mëvonshme. Në këtë kuptim, termi periudhë ka qenë për atë më i pranueshëm, sepse mbulon kontradiktën që lind prej tij: fjalia e përbërë përbëhet prej fjalish.

Fjalinë e përbërë (ose periudhën) S. Floqi e kupton si një njësi sintaksore që formon një të tërë nga intonacioni dhe kuptimi, po e përbërë prej dy ose më shumë fjalish të thjeshta, të cilat brenda tërësisë nuk janë të mbaruara nga kuptimi dhe nga intonacioni¹⁸. Gjithashtu ai pranon që midis fjalisë dhe periudhës nuk ka ndryshime të rëndësishme. Si fjalia dhe periudha karakterizohen nga intonacioni i mbaruar dhe nga komunikimi i plotë. Ato janë dalluar si dy njësi duke u nisur vetëm nga përbërja e tyre strukturore¹⁹, sepse periudha përbëhet prej dy ose më shumë njësisish kallzuesore, fjalish.

Një kuptim i tillë i periudhës është një hap i madh përpara, i cili ka pasur pasoja pozitive dhe në studimin konkret të strukturës sintaksore të shqipes. Ndryshe nga sintaksat, në studimet sintaksore periudha është

13) S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF 1958, 1, f. 81.

14) S. Floqi, *Fjalia e përbërë e bashkërenditur...* BShSh 1956, 2, f. 4.

15) S. Floqi, *Po aty*, f. 4.

16) S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, SF 1965, 2, f. 55-97; *Periudha me fjali të varur kryefjalore I, II*, SF 1965, 3, f. 3-36; 4, f. 3-37; *Periudha me fjali të varur shkakore I, II, III*, SF, 1966, 2, f. 3-41; 1966, 3, f. 3-48, 1967 1, f. 13-33 etj.

17) S. Floqi, *Rreth disa çështjeve...*, BSHSH 1955, 3, f. 2; *Fjalia e përbërë*, BSHSH 1956, 2, f. 8.

18) S. Floqi, *Po aty*.

19) S. Floqi, *Rreth disa çështjeve...*, BSHSH 1956, 2, f. 6. Shih për këtë edhe M. Do-mi, *Sintaksa e gjuhës shqipe* (Material për studentët e Fakultetit historik-filologjik) T. 1968, f. 2.

studjuar si një e tërë intonacionore dhe kuptimore, ku pjesët përbërëse janë të lidhura dhe kushtëzojnë njëra-tjetrën nga pikëpamja kuptimore dhe strukturore.

Po, nga ana tjetër, natyra sintaksore e periudhës nuk mund të thuhet ende që ka gjetur një shpjegim plotësisht të pranueshëm teorik. Pranimi i periudhës si njësi sintaksore e përbërë prej fjalish bie në kundërshtim me kuptimin e fjalisë si njësi komunikative e ligjëritim. Pjesët e periudhës nuk mund të jenë në asnjë mënyrë të formuara gramatikisht ashtu si një fjali e veçuar. Kjo duket qartë jo vetëm në mungesën e intonacionit të mbaruar, po dhe në varësinë reciproke strukturore që shprehet në plotësinë ose paplotësinë strukturore (paralelizimi strukturor), në rendin e fjalëve në secilën pjesë të periudhës, në praninë ose mospraninë e korrelatëve, në korrelacionin kohor të foljeve-kallzues etj. Të pranosh në këto kushte pjesët e periudhës si fjali, do të thotë që, të paktën teorikisht, të mos marrësh parasysh lidhjen dhe kushtëzimin reciprok të këtyre pjesëve, t'i kuptosh ato të veçuara. Në fund të fundit, kjo do të thotë ta kuptosh fjalinë si njësi strukturoro-formale, si një ndërtim i caktuar kallzuesor, e të qëndrosh me një këmbë në gjuhësinë tradicionale.

Këto kontradikta teorike nuk mund të mos kenë pasoja në përshkrimin sintaksor dhe në interpretimin e fakteve sintaksore. Le të shohim këtu vetëm çështjen e ndërtimeve me forma foljore të pashtjelluara.

Siç është thënë edhe më lart, në sintaksat shkollore këto ndërtime janë trajtuar përgjithësisht si fjali dhe janë klasifikuar sipas kuptimit në rubrikat e ndryshme të fjalive të varura. Vetëm J. Rrota në sintaksën e vet i trajton edhe si gjymtyrë, edhe si fjali të varura, pa ndonjë kriter të qartë, kurse M. Domi format foljore të pashtjelluara, që nuk shoqërohen me fjalë të tjera, vetëm këto, i trajton si gjymtyrë fjalie²⁰.

S. Floqi, duke u nisur nga fakti se këto ndërtime nuk shprehin kategoritë gramatikore të mënyrës, të kohës dhe të vetës, (pra nuk kanë një «verbum finitum») dhe se nuk kanë një strukturë të ngjashme me atë të fjalisë, nuk i trajton si fjali dhe propozon që të studjohen në teorinë e fjalisë (jo të periudhës) si «gjymtyrë të përbëra» (ose komplekse). pra, si «cilësor i përbërë», «kundrinë e përbërë», «plotës kohe i përbërë» etj.²¹

Reagimi ndaj gramatikave të shqipes në lidhje me këtë çështje është plotësisht i drejtë, por edhe ky propozim ka mjaft anë të paqarta dhe s'paraqet leverdi praktike, në vend që të qartësojë problemin e ngatërron më keq. Këtu nuk është fjala vetëm për termin «i përbërë», të cilit i është dhënë edhe përmbajtje tjetër,²² po për kuptimin e natyrës gramatikore të kësaj «gjymtyrë të përbërë». Ku qëndron karakteri i përbërë i kësaj gjymtyrë: në numrin e gjymtyrëve të saj, apo në ndonjë send tjetër? Mendoj që këting problemi i duhej kushtuar një vëmendje më e madhe.

Le të marrim dy shembuj:

— Mirë u kujtove, o burra në zjarr, sa pa ardhur fshati. (J. Xoxa, LV II, 182).

Plakut i pëlqeu shakaja dhe shkoi duke qeshur.

20) M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa II, Sintaksa*, T. 1957, f. 133.

21) S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme*. në «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», T. 1965, f. 223.

22) M. Çeliku, *Disa togje foljore në shqipen e sotme* (sipas materialeve të të folmeve të Shqipërisë së mesme), BUSHT SSHSH 1963, I, f. 178; M. Totoni, *Konstruktive me folje aspektive të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe*, SF 1968, I, f. 94.

Në shembullin e parë, ndërtimi *sa pa ardhur fshati* është i përbërë prej fjalësh si: folja (pa) *ardhur* dhe emri *fshati*, që janë fjalë kuptimplotë dhe kryejnë funksionin e gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë. Edhe për strukturën e këtij ndërtimi nuk mund të thuhet se s'është e ngjashme me atë të fjalisë. Ky ndërtim është formuar mbi bazën e lidhjes kallzuesore (predikative), që është karakteristike për fjalinë. Kuptimi modal dhe kohor i këtij ndërtimi bëhet i qartë nga konteksti, nga përqasja me foljen - kallzues të pjesës tjetër, ndërsa kuptimi i vetës është shprehur sintaksorisht me anë të pranisë së emrit në rasën emërore, që funksionon si kryefjalë. Është e vërtetë që ky ndërtim nuk shpreh ndonjë mendim të plotë, po kjo është po kaq e vërtetë edhe për «fjalinë e varur» *sa s'ka ardhur fshati*, që është sinonimike me *sa pa ardhur fshati*.

Në shembullin e dytë, përcjellorja *duke qeshur* s'mund të pranohet si «gjymtyrë e përbërë», sepse është vetëm një fjalë. Atëhere ku duhet klasifikuar?

Në këto gjymtyrë të përbëra janë përfshirë ndërtime cilësisht të ndryshme: nga një anë, ndërtime të tilla që s'pranojnë kryefjalë, që kanë të njëjtin subjekt me pjesën tjetër, dhe, nga ana tjetër, ndërtime me forma foljore të pashtjelluara, që kanë kryefjalë dhe që mund të fitojnë edhe tipare të tjera të «fjalisë së varur», mund të marrim lidhëz nënrenditëse. Studimi i ndërtimit të grupit të parë në teorinë e fjalisë është plotësisht i justifikueshëm, po kjo gjë nuk mund të thuhet edhe për ndërtimet e grupit të dytë. Trajtimi i ndërtimeve me forma foljore të pashtjelluara, që kanë kryefjalë, nuk mund të ndahet nga trajtimi i përgjithshëm i fjalive të varura si fjali apo si pjesë kallzuesore të një njësie të vetme të fjalisë. T'i ndash këto ndërtime nga fjalitë e varura, do të thotë ta shohësh çështjen e «verbum finitum» si një tipar absolut të fjalisë e me këtë ta kuptosh fjalinë si njësi strukturore dhe jo si njësi të ligjërit.

Për ta zhdukur këtë kontradiktë, ka vetëm një rrugë: e ashtuquajtura periudhë të kuptohet si tip fjalie — si *fjali e përbërë*, pra jo si njësi sintaksore e ndryshme nga fjalia, dhe të ashtuquajturat fjali në përbërjen e «periudhës» të mos kuptohen si fjali, pra si njësi sintaksore, po si pjesë kallzuesore (predikative) të saj.²³ Kështu fjalia, njësia themelore sintaksore, do të ndahet në dy tipe themelore, në *fjali të thjeshtë* që ka një bërthamë kallzuesore, dhe në *fjali të përbërë* që ka dy a më shumë bërthama kallzuesore, pjesë.

23) N. S. Pospjellov, O grammatičeskoj prirodje slozhnogo predložhenija, në «Voprosy sintaksisa sovremennogo russkogo jazyka», M. 1959, f. 336.